Edwin Robert Schwartz, lindur në Tiranë, ku studioi për Gjuhë-Letërsi në Fakultetin Filologjik dhe më pas, për Letërsi Krahasuese (Master Shkencor) në "Brooklyn College" të Universitetit të Qytetit të Nju-Jorkut.

I diplomuar në "Shkollën Shqiptare të Studimeve Politike" si dhe i çertifikuar nga Shkolla Verore e Këshilli i Evropës, 2008-09.

Nga 1992 deri në 2003 ka jetuar, studiuar dhe punuar në Shtet e Bashkuara, ku ka qenë edhe bashkëpunëtor dhe përkthyes i jashtëm i "Helsinki Human Rights Watch" 1996-2001.

Anëtar i bordit të "Grupit Shqiptar të të Drejtave të Njeriut" (që nga krijimi i tij në vitin 1996).

Nga marsi 2004, i punësuar në Institucionin e Presidentit të Republikës, si përkthyes zyrtar i ish-Presidentëve Moisiu, Topi, Nishani dhe Meta, fillimisht si Specialist i Medias, e më pas si Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë, Protokollit dhe i Informimit Publik (Medias) në gusht 2022.

Nga viti 1988 ka botuar përkthime të ndryshme dhe artikuj, analiza e botime periodike, kryesisht në prozë, në gazeta dhe revista letrare e të përditshme si: "Drita", "Zëri i Rinisë", "Mehr Licht", "Illyria", "AKS", "Albania", "Korrieri", "Saras", "Milosao", "Antologjia e tregimit shqiptar", duke përkthyer një duzinë romanesh nga nobelistë të huaj, libra biografikë dhe albume artistikë nga autorë dhe artistë shqiptarë.

I vlerësuar me "Medaljen e Trimërisë" në vitin 1995; me "Dekoratën e Flamurit Kombëtar" për studentët dhe pedagogët e LSSH-së 1990-91, më 8 dhjetor 2015; si dhe më 20 shkurt 2017, me Dekoratën "Nderi i Kombit" e përbashkët për 723 ish-studentët dhe pedagogët pjesëmarrës në Grevën e Urisë së 18-20 shkurtit 1991, të dhënë nga ish-Presidentët e Republikës së Shqipërisë.